

 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep. Dep. Dep. DPK/DMP	Nr. Prot. Prot. No. 03-4009/12	
Nr. Ligj. Broj. Zakona Nr. Kushtes. 02	Data Datum 06.11.2012	
PRISHTINE		

Nr. regj. 18224/12

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Beqir Haki Ismaili nga Fushe Kosova, për kundërvajtje nga neni 5,6 paragrafi 1.2 dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 te Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave te Zyrtareve te Larte Publik nr. 03/L-151, e ne baze te nenit 73.73.195, 199 si dhe neni 9 te Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 17.10.2012, merr këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Beqir Haki Ismaili, i lindur më 04.10.1959 në fsh. Smalic-Bujanovc, ku edhe tani jeton ne Rr. Rr. Lidhja e Prizrenit nr. 20, i martuar baba i katër fëmijëve, Zëvendës Konsull ne Ambasadën e Kosovës ne Arabi Saudite-Riad, me shkollim superior, i gjendjes se mesme ekonomike, deri tani thotë jo i dënuar.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse me si Zyrtar i larte Publik, ne Pozite **Zëvendës Konsull ne Ambasadën e Kosovës ne Arabi Saudite-Riad**, nuk e ka bere deklarimin e rregullt te gjendjes se pasurisë ne Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor me 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin neni 5,6 paragrafi 1.2 he neni 8 paragrafi 1 dhe 2 si dhe neni 9 te ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 te Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Zyrtareve te Larte Publike**, andaj te pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

DENIMI

Me gjobë në shumë prej **700 (shtatëqind)** Euro. Gjobjën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda 15 ditësh pasi që aktvendimi të merr formën e prerë në favor të hyrave gjyqësore të KGJK-ës në llogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata.

Po qe se brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjobjën e njejta do ti zëvendësohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditësh), duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) euro në një ditë burgimi.

Në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **5 (pesë)** Euro në afat të njejtë sikurse gjobjën në të njëjtën llogari rrjedhëse. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencinë Kundër Korrupsionit ne Prishtine, parashtrori kërkesën nr. 01 1821/12 të dt. 21.05.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj te pandehurit te shënuar për kundërvajtjen e precizuar si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen ne pyetje te pandehurin, i cili ne mbrojtjen e vet deklaroi se Zëvendës Konsull ne Ambasadën e Kosovës ne Arabi Saudite-Riad, nuk e ka bere deklarimin e pasurisë brenda afatit ligjor te mbi deklarimin e Pasurisë deri 31 mars 2012 pasi nuk ka pasur dijeni se pozitën te cilën e ushtron është i obliguar për ta deklaruar pasurinë dhe për here te pare është duke e ushtruar një pozite e cila e obligon për deklarimin e pasurisë.

Nga te dhënat ne kërkesë, vlerësimin i deklaratës se te pandehurit, ushtruesit te Kërkesës Agjencisë Kundër Korrupsionit, dhe baze të dhënave te parashtruara në kërkesë, shqimit të shkresave të lendes dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri, ka bërë kundërvajtje ashtu si e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtor dhe është dënuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK morri si rrethanë lehtësuese rastin ushtrimin e pozitës se larte për here te pare, përmbushja e obligimit për deklarimin e pasurisë menjëherë pasi ka kuptuar se është i obliguar ta përmbush këtë obligim mbi deklarimin e pasurisë, si mos kontakti

03-4009/12/02
fmg

i mjaftueshëm me Agjencinë kundër Korrupsionit pasi i pandehuri pozitën e tij e ushtron në Arabinë Saudite-Riad, por nuk e arsyetoi për mos dijenin e mjaftueshëm për tu për përgjigjur obligimeve të tija ligjore nga Agjencinë Kundër Korrupsionit, andaj të pandehurit i shqiptoi gjobën e zbutur, duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit të i pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARJA

Lindita Jakupi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit dhe pa taksa.